



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivered	25.11.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organi / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKVINSHCK	7420/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.848/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.848/2022, të datës 03.10.2022, së ankuesit [redacted] me adrese banimi [redacted]

kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.11.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr. 848/2022, të datës 03.10.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. SHFUQIZOHET Vendimi i datës 09.09.2022, me numër protokolli 1941/2022, i Komisionit për lëvizje brenda kategorisë i Ministrisë së Financave punës dhe Transfereve.

II. ANULOHET, Konkursi i datës 04.07.2022, për pozitën „Zyrtar për Pensione“, lëvizje brenda kategorisë i Ministrisë së Financave punës dhe Transfereve, si dhe njoftimi i datës 30.08.2022, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm.

IV. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave punës dhe Transfereve, që në afatin prej përmbledhjet (15) ditësh që të bëjë zbatimin e vendimit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi me datë 03.10.2022, me numër të protokollit 5823/2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „ Zyrtar për Pensione” të zhvilluar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, kundër Vendimit datës 09.09.2022, me numër protokollit 1941/2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 10.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Financave punës dhe Transfereve. Ndërsa me datë 14.10.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritorë, ka administruar këto prova: Ankesa A.nr. 848/2022 e të datës 03.10.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 09.09.2022, i Komisionit për Lëvizje brenda kategorisë; Njoftimi i ditës 30.08.2022, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm; Rezultatet e vlerësimit, Konkursi i datës 04.07.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Vërtetim i datës 08.10.2003; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Diplomë e datës 04.07.2021; Diplomë e datës 22.06.1994; Akt Emërimi i datës 28.12.2017; Vendim i datës 18.04.2018; Vendim i datës 01.08.2022; Vendimi i datës 08.08.2022, i Divizionit për Burime Njerëzore; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë e datës 11.07.2018; Akt Emërimi i datës 08.02.2012; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 26.01.2010; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 04.02.2009; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 23.01.2007; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë e datës 01.07.2014; Akt Emërimi i datës 14.09.2013; Akt Emërimi i datës 13.10.2014; Akt Emërimi i datës 01.08.2013; diplomë e datës 14.01.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; E-maili i datës 15.08.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 03.05.2017; Diplomë e datës 28.05.2021; Akt Emërimi i datës 12.11.2019; Akt Emërimi i datës 02.11.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Përgjigje në ankesë e datës 14.10.2022, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton së në konkursin e shpallur të datës 04.07.2022, për pozitën „ Zyrtar për Pensione”, Zyra Regionale Pejë, nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, kriteret formale të konkursit kanë qenë:



- Diplome Universitare, me të paktën 180, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to, në Drejtësi, Ekonomi dhe Shkenca Sociale,
- Se paku dy (2) vite përvoja pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë.

Ndërlidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit, përkatësitë konkursin e shpallur me datë 04.07.2022, për pozitën „Zyrtar për Pensione“, Zyra Regjionale Pejë, nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, Kolegji konstaton se Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, kriteret e konkursit, i ka përcaktuar sipas nenit 18 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku shprehimisht thuhet se; 2. Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkesat për zotërimin e arsimit që përfshin nivelin dhe fushën e arsimit, kualifikimin apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për atë pozitë përkatëse, por gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit ka pranuar kandidatin e cila nuk ka të përfunduar studimet adekuate sipas kriterëve të shkollimit të kërkuara në konkurs.

Pas zhvillimit të procedurës së rekrutimit Komisioni për vlerësim brenda kategorisë, i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, ka bërë renditje përfundimtarë me të cilin kandidaten [redacted] e ka vlerësuar me gjithsejtë tetëdhjetë e shtatë pikë katër (87.4), Kolegji konstaton se pas rekomandimit të Komisionit për Vlerësim brenda Kategorisë. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, më datë 30.08.2022, ka njoftuar kandidaten, si kandidatë të suksesshme.

Ndërlidhur me rekomandim e Komisioni për Vlerësimin për Lëvizje brenda kategorisë, për [redacted] si kandidate të suksesshëm për pozitën „Zyrtar për Pensione“, në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ka vepruar në kundërshtim me nenin 25, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet;1.Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurrimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj. 2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregullore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje brenda kategorisë, i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, në rastin e përzgjedhje se kandidates së suksesshme, ka vepruar edhe në kundërshtimin, me nenin 15, paragrafi 1,2,3 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet;1.1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe

verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlihen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë,

Pas konstatimit të gjendjes faktike dhe bazës juridike, sa i përket zhvillimit të procedurës së rekrutimit. Kolegji konstaton se është përfshirë në listën e ngushtë dhe nga Komisionit për vlerësim i lëvizjes brenda Kategorisë është rekomanduar si kandidate e suksesshme për pozitën „ Zyrtare për Pensione”, prandaj Kolegji pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, shqyrtimit analizimit të provave dhe vërtetimit të tyre, ka konstatuar se kandidatja në bazë të shqyrtimit të aplikacionit del se kandidatja në bazë të certifikatës me numër Ref- 150 B-14, të datës 01.07.2014 së lëshuar, nga Universiteti “Haxhi Zeka”, ka përfunduar “Baçelor i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis”, si dhe në bazë diplomës me numër 438, e datës 14.01.2019, del se ka përfunduar „ Master i Shkencave në Menaxhim të Burimeve Njerëzore”, dhe mbi bazën e kësaj kolegji konstaton se kandidatja e rekomanduar si kandidatja e suksesshme, nuk i ka plotësuar kushtet formale, sipas konkursin të shpallur me datë 04.07.2022, për pozitën „ Zyrtar për Pensione”, sepse kandidatja e rekomanduar nuk ka poseduar përgatitje profesionale, ashtu siç është kërkuar në konkursin e shpallur nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve.

Kolegji, pas shqyrtimit të ankesës, se ankuesi vërtetimit e provave, konstatim të gjendjes faktikë, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit, vendosi si në diapozitiv të këqij vendimi, Kolegji konstaton se Organi i punësimit Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, është e obliguar që pas pranimit të këtij vendimi të Këshillit, të ndërmarrë veprimet sipas diapozitivit të vendimit të Këshillit, të anuloj konkursi, të veprojë në pajtim me Ligjin nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.848/2022

Ruslir KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Arkivit të KPMSHCK-së.